



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 146, Datë 06.06.2022

MBI

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT
NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË “HEC-I KABASH POROCAN” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/9 prot., datë 02.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC-I KABASH POROCAN” sh.p.k.”

Konstatoi se:

- Shoqëria “HEC-i KABASH POROCAN” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.07.2015, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.07.2015.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/1 prot., datë 17.02.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave nga shoqëria “ERPA INVEST” sh.p.k. te shoqëria “DUFERCO ALBANIA” sh.p.k.
- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezultoi se kishte mungesë dokumentacioni, ndaj ERE iu drejtua me shkresën nr. 196/2 prot., datë 24.03.2022, duke i evidentuar sa më sipër.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/3 prot., datë 07.04.2022, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion, por duke qenë se ky aplikim nuk ishte ende i plotë dhe duke marrë në konsideratë faktin që shoqëria nuk ishte plotësisht e qartë në lidhje me dokumentacionin e këtij aplikimi, ERE i dërgoi shkresën vijuese me nr.

196/5 prot., datë 18.05.2022. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/6 prot., datë 23.05.2022, shoqëria ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim sqarimin/dokumentimin e mbështetjes financiare, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HEC-I KABASH POROCAN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HEC-I KABASH POROCAN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e ordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI